



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 31-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27.04.2021, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 13⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Hyra Bytyçi, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani
4. Albulena Kelmendi, anëtare
5. Ukë Kryeziu, anëtar
6. Afrim Miftari, anëtar
7. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Bekim Shabani, DEZH
3. Shefqet Amërlahu DB

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 30-të e KPF-së.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2021.
3. Propozim vendim për aprovimin e rezervës komunale 2021-2023.

4. Propozim vendim për lirim nga pagesa e qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.
5. Propozim rregullore për taksat komunale.
6. Propozim vendim për fillimin e procedurave për krijimin e Ndërmarrjes publike lokale "Ulpiana" sh.a.
7. Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 7 për, aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 30-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari, tha unë e pata një vërejtje të vogël por bisedova me procesmbajtësin për me ndryshu.

Daut Azemi, ne kur po bisedojmë rreth ndonjë pike, po jemi interaktiv në bisedë herë njëri herë tjetri, nëse bisedojmë me rend atëherë procesmbajtësi mund t'i shënoj të gjitha e nëse vazhdojmë me bisedë interaktive procesmbajtësi do ta ketë problem.

Megjë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 30-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2021

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, tha se kjo pikë propozoj që të shkon direkt për kuvend

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimin që të kaloj direkt në kuvend, me të gjitha vota për kaloi kjo pikë..

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim

.

III

Propozim Vendim për aprovimin e rezervave komunale 2021-2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Latif Ramadanit , drejtor i DBF, e cill në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, në këtë propozim vendim nuk ka arsyetim dhe do të duhej të kishte një arsyetim. Rezervat me u planifikuar për investime kapitale jo e drejtë pasi qe dihet qe jemi në kohë pandemie dhe askush nuk mund të dijë se çka do të ndodhë me tutje, është dashtë të mendohet që kët rezerva të shfrytëzohen te mirëqenia e qytetarëve. Unë nuk do ta votoj në propozim të tillë derisa sa një shumë nuk do të ndahet për këtë kategori.

Albulena Kelmendi, edhe unë pajtohem me parafolësen që rezervat komunale të harxhohen për investime kapitale .

Ukë Kryeziu,edhe unë pajtohem me parafolësit pasi që rezervat komunale duhet të dihet ku të harxhohen për shembull në shëndetësi mjetet të cilat janë planifikuar për investime kapitale do të duhej të harxhohen në material shpenzues në barna e material tjetër të nevojshëm.

Latif Ramadani, keni të drejtë për vërejtjen që po e jepni por kjo na ka ardhur nga ministria dhe ministria ka një program të veçantë dhe në këto mjete i kemi votuar më herët në kuvend

Afrim Miftari,unë i kam dy pyetje; e para ka të bëjë me shpenzimet për vitin 2022 të rrugëve të QMI,për cilat rrugë bëhet fjalë. Dhe të rrugët e kategorisë së 4 për çka është fjala.

Latif Ramadani,te QMI është një rrugë që i lidhë dy magjistralet,ndërsa rrugët e kategorisë së 4 të janë ato rrugë publike në të cilat afër tyre kanë filluar të ndërtohen shtëpi e të cilat janë të pa asfaltuara.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për,dhe 1 abstenim, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim vendim për lirimin nga pagesa e qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i a dha fjalën,Bekim Shabani,drejtoi i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Lumturije Bytyqi-Hasani,shumë i qëlluar ky propozim vendim,por kam edhe një propozim që të zgjerohet dhe të përfshihet edhe gastronomia pasi gjatë mbylljes kanë pas humbje,të lirohen nga pagesa e shfrytëzimit të pronës publike. Do të ishte mirë që në të ardhmen të ketë një propozim në kuvend.

Fehmi Rexhepi, unë kam për ta ngritur një shqetësim për një lokal të cilin e kena marrë pjesë në mirëpo asnjëherë nuk kemi mujtë me shfrytëzuar pasi që është mbushur me ujë dhe nuk po kemi mundësi me pagu.

Daut Azemi, është mirë me ju drejtu me një kërkesë drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim dhe të shohim se çka mund të veprojë.

Bekim Shabani, për çështjen e bizneseve, kemi biseduar me kryetarin dhe në seancat në vijim do të propozojmë për kuvend.

Daut Azemi,jo të gjitha kategoritë kanë mbetë pa punuar por ne jemi duke i analizuar së bashku me kryetarin se cilat kategori duhet të përfshihen.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim rregullore për taksat komunale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën,Bekim Shabanit drejtor i DEZH,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani,ne ne këtë kuvend kemi votuar një rregullore ku ka qenë një nen që kompanitë të cilat e bllokojnë rrugën me marrë leje në komunë për ta bllokuar rrugën dhe aty ka qenë një taksë e cila duhet të paguhet. Nuk e di a është duke u zbatuar ajo ose jo?

Bekim Shabani,po është duke u zbatuar dhe ata të cilët nuk po e zbatojnë po gjobiten nga inspekcioni.

Afrim Miftari, nëse nuk zbatohet a mundet t'i gjobitë vetëm inspekcioni apo edhe policia.

Daut Azemi, ka koordinim në mes të policisë dhe inspekcionit rreth kësaj çështje.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim vendim për fillimin e procedurave për krijimin e Ndërmarrjes publike lokale " Ulpiana" sh.a.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabanit drejtor i DEZH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Hyra Bytyçi një propozim vendim i qëlluar dhe e përkrahim. Kam një pyetje a do të jetë aksionare vetëm komuna e Lipjanit apo edhe komunat tjera.

Lumturije Bytyqi-Hasani,hera e parë qe kemi një propozim vendim të tillë,por kjo don një kosto të madhe dhe si do të funksionalizohej kjo. A do të merret buxheti nga ajo qe e kemi nda na në kuvend.

Afrim Miftari,Eshtë e mirë që po bëhet kjo pasi që do të krijohen edhe vende të punës.Kush janë aksionarët e mundshëm dhe si ka me funksionu.

Bekim Shabani,pas votimit në kuvend dërgohet së bashku në ministri me një kërkesë. Aksionar do të jetë vetëm komuna e Lipjanit.

Daut Azemi,disa komuna kanë filluar që ti themelojnë ndërmarrjet te tilla.

Ukë Kryeziu,nuk e di sa na lejon baza ligjore të kemi kaq shumë shërbime. Për tu themeluar kjo duhet një buxhet shumë i madh pasi qe kjo ndërmarrje vetëm harxhon. Niveli qendror duhet ta bëjë një rregullore qe keto komunat t'i kenë nën menaxhimin e tyre. Mos po duhet tani t'i shuajmë këto ndërmarrje siç janë shuar disa qe kanë qenë më herët.

Afrim Miftari mirë që po themelohen këto pasi që do t'i kryejnë disa shërbime siç po i kryen kompania pastrimi e ku edhe qytetarët po i bëjnë pagesat

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën,Shefqet Amerllahu,drejtori DB, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari,kam një propozim që përveç serave të ketë edhe motokultivator pasi që ka kërkesa të qytetarëve.

Ukë Kryeziu,qe 8 vite që jam anëtar i kuvendit të njëjtat mjete po shpërndahen,vetëm një herë ka pas koshere të bletëve.Unë nuk jam i knaqur me

subvencionet të cilat po ndahen në bujqësi, pasi që është dashtë të ketë subvencione edhe në blegtori, pemëtari dhe të bëhen analiza se ku ka nevojë më shumë të investohet.

Shfaqet Amërlahi, kërkesat e qytetarëve kanë qenë në sera mirëpo ne në bashkëpunim me disa organizata kemi nda subvencione edhe tjera si mjete pune për bujqësi, blegtori e tjera.

Daut Azemi, me këto subvencione po ju ndihmohet me shumë ekonomive familjare, pasi që sa i përket bujqësisë po marrin subvencione nga ministria si për drithëra si për pemë, perime, qumësht.

Hyra Bytyçi, unë kam një propozim që të ketë edhe makina mjelëse, pasi që ka kërkesa të qytetarëve.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,⁵⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi